



REPUBLIKA E KOSOVËS-ZYRA E PRESIDENTIT  
REPUBLIKA KOSOVO-URED PREDSEDNIKA  
REPUBLIC OF KOSOVO-OFFICE OF THE PRESIDENT

KËSHILLI KONSULTATIV PËR KOMUNITETE  
SAVETODAVNO VEĆE ZA ZAJEDNICE  
CONSULTATIVE COUNCIL FOR COMMUNITIES

## **RAPORTI NGA TAKIMI – DISKUTIMI I MBAJTUR “ARSIMI I KOMUNITETEVE JO SHUMICË NË KOSOVË- SFIDAT DHE ZGJIDHJET” 09 MARS 2016**

Këshilli Konsultativ për Komunitete, në bashkëpunim me përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë si dhe atyre të Ambasadës Amerikane në Prishtinë dhe, e ka mbajtur takimin - diskutimin, më 09 mars 2016, me temë “Arsimi i komuniteteve jo shumicë në Kosovë – sfidat e zgjidhjet.”

Gjatë takimit- diskutimin Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Arsim Bajrami, ua prezantoi përfaqësuesve të komuniteteve jo shumicë në Kosovë në Këshillin Konsultativ për Komunitete, deputetëve të Parlamentit të Republikës së Kosovës nga komunitetet jo shumicë, përfaqësuesve të institucioneve shtetërore që merren me çështje të komuniteteve jo shumicë dhe përfaqësuesve ndërkombëtarë në Kosovë, planet e afatgjata të Ministrisë që janë të fokusuar në arsim të barabartë të qytetarëve të Republikës së Kosovës nga komunitetet jo shumicë.

Përveç të anëtarëve të Këshillit Konsultativ për Komunitete, në takim morën pjesë edhe: deputetët e Kuvendit të Kosovës: Emilija Redžepi dhe Kujtim Paqaku, Ambasadori i Mbretërisë së Norvegjisë, Jan Braathu, Drejtori i USAID-it në Kosovë, James Hope, përfaqësuesi i Zyrës së Avokatit të Popullit, përfaqësuesit e Drejtorive për Arsim nga komunat e Prishtinës dhe të Prizrenit, përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane, Ambasadës Franceze dhe Ambasadës Zvicërrane, si dhe përfaqësuesit e OSBE-së dhe të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë.

**Kryesuesi i Këshillit Konsultativ për Komunitete, z. Darko Dimitrijević** në fillimin e diskutimit të tij iu falënderua përfaqësuesve të Ambasadës Amerikane për bashkëpunimin në lidhje me realizimin e takimit – diskutimit për çështjen e arsimit të komuniteteve jo shumicë, Ambasadorit të Mbretërisë së Norvegjisë, z. Janu Braathu iu falënderoi për mbështetjen që vendi i tij vazhdimisht ia ofron Këshillit Konsultativ për Komunitete. Z. Dimitrijević gjithashtu iu falënderua edhe pjesëmarrësve të tjerë në takim dhe e vlerësoi

organizimin e takimeve të tilla, ku diskutohet për temat kyçe për komunitet jo shumicë në Kosovë dhe që e ngrit transparencën dhe rëndësinë e Këshillit Konsultativ për Komunitete.

**Sekretarja e përgjithshme e Këshillit, znj. Nafiye Gaš** theksoi se organizimi i një takimi të tillë nga Këshilli Konsultativ për Komunitete, i cili funksionon nën patronatin e Presidentit të Republikës së Kosovës, edhe një herë dëshmon që ky Këshill është një ndër mekanizmat kyçe që shërben për komunikim dhe konsultim mes komuniteteve dhe institucioneve të vendit me qëllim të realizimit të drejtave të tyre për pjesëmarrje në jetën publike në Kosovë. Në diskutimin e saj të mëtejshëm, znj. Gaš i ka nënvizuar sfidat me të cilat po ballafaqohet Këshilli në realizimin e mandatit të tij, mes të cilave janë edhe mungesa e vazhdueshme e mjeteve buxhetore, dhe me këtë rast iu falënderua Ambasadorit të Mbretërisë së Norvegjisë për mbështetje financiare që ia dha Këshillit si dhe partnerëve të tjerë nga komuniteti ndërkombëtar për mbështetje.

**Kryesuesi i Grupit punues për çështje të Arsimit, pranë Këshillit Konsultativ për Komunitete, z. Mejdin Saliji** ka theksuar se që nga themelimi i Grupit punues për Arsim, ky grup vazhdimisht i ka vëzhguar kushtet e arsimit të komuniteteve jo shumicë në Kosovë. Ka theksuar se ky grup, përfundimet e veta dhe sugjerimet gjithmonë ia ka dhënë në shikim me transparencë dhe në kohë Presidentit të Kosovës, pushtetit qendror dhe atij lokal, si dhe publikut kosovar. Z. Saliji i përshëndeti përpjekjet e Qeverisë, Zyrës për komunitete dhe të partnerëve nga komuniteti ndërkombëtarë për ta zgjedhur më në fund, çështjen e njohjes së diplomave të fituara në Universitetin në Mitrovicën e Veriut, për t'ua mundësuar të gjithë qytetarëve barazinë gjatë procesit të punësimit nëpër institucione publike të Republikës së Kosovës. Në vazhdim të diskutimit të tij, z. Saliji iu falënderua Qeverisë së Kosovës se gjatë 16 viteve të fundit e mundësoi përkthimin e planit unik arsimor të Kosovës në gjuhët e komuniteteve jo shumicë, për vendet e rezervuara në universitetet publike të Kosovës dhe për mundësinë e dhënies së provimit në gjuhën amtare të kandidatëve nga komuniteti etnik jo shumicë, madje edhe atëherë kur mësimet zhvillohen në gjuhën shqipe, atje ku kjo gjë është e mundur. Saliji gjithashtu u falënderua për lejen nga viti i kaluar që tekstet mësimore për nxënësit e programit në gjuhën boshnjake të importohen pa kusht nga Bosnja dhe Hercegovina, por edhe për mundësinë që është paralajmëruar kohëve të fundit që nxënësve të shkollave të mesme t'iu mundësohet që provimin pranues ta japin në gjuhën amtare gjatë regjistrimit në universitetet shtetërore në vend. Saliji e vlerësoi se këto masa në një masë të madhe e kanë lehtësuar arsimin e pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë në Kosovë.

Në diskutimin e mëtejshëm, z. Saliji i ka paraqitur edhe problemet që ende i brengosin komunitetet jo shumicë në fushën e arsimit:

- Miratimi i ndryshimit të Ligjit për Arsimin e lartë;
- Ndryshimi i Rregullores Administrative të MASHT-it në lidhje me raportin e numrit të nxënësve dhe mësimdhënësve në mësimdhënie në shkollat fillore në gjuhët e komuniteteve jo shumicë në qytete;

- Mbështetje për botimin e librave shkollorë si dhe shtypja e librave të mbetur për shkollë fillore dhe shkollat e mesme të ulëta dhe të lekturës përcjellëse ( fletorët punuese, fletore ushtrimesh, lektura shkollore, tekstet shkollore...), si dhe
- shtypja e librave profesionale për shkollat e mesme të larta të cilat duhet të përkthehen nga gjuha shqipe;
- Sigurimi i buxhetit të përhershëm për importimin e librave nga Bosnja dhe Hercegovina (atyre që mungojnë) me prioritet të librave nga grupi nacional i lëndëve për ta parandaluar shuarjen e arsimit në gjuhët e komuniteteve jo shumicë dhe emigrimin:
- Organizimi i trajnimeve për mësime të mësimdhënësve nga komunitetet jo shumicë që për qëllim kanë edhe aplikimin e këtij plani mësimor dhe trajnimeve të ECDL-it;
- Zgjedhja e zëvendës drejtorëve nga komunitetet jo shumicë në shkolla ku mësimi zhvillohet në gjuhët e komuniteteve jo shumicë;
- Paraqitja e orëve të gjuhës shqipe nga klasa e parë në shkolla fillore si dhe orët e gjuhës shqipe për të gjithë ata që duan ta mësojnë gjuhën shqipe për shkak të punësimit, me qëllim të integritetit më të lehtë dhe të mbijetesës së komuniteteve jo shumicë në Kosovë;
- Shtypja e teksteve shkollorë të Gjuhës shqipe si gjuhë jo amtare, të parashikuara me plan dhe program;
- Konfirmimi i kriterit për regjistrimin e studentëve në studimet Bachelor dhe ato Master, me një rregullore të veçantë nga Ministria në universitete shtetërore, për t'u siguruar stafi mësimdhënës për të gjitha nivelet e arsimit;
- Marrëveshja me komunitete rreth futjes së drejtimeve të reja arsimore për t'i mundësuar pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë të studiojnë në drejtime për të cilat ekziston kërkesa në tregun e punës siç janë medicina, arkitektura dhe të ngjashme si dhe hapja e drejtimit ekonomik në Universitetin publik në Prizren;
- Sigurimi i testeve për provimin pranues për institucionet e arsimit të lartë në gjuhët e komuniteteve jo shumicë;
- Mundësimi i arsimit parashkollor në gjuhët e komuniteteve jo shumicë në të gjitha shkollat ku mësimet zhvillohen në gjuhët e komuniteteve jo shumicë si dhe sigurimi i teksteve shkollorë, duke marrë parasysh se deri sot nuk ekziston asnjë libër shkollor në institucionin parashkollor në gjuhët e komuniteteve jo shumicë.

Z. Saliji e ka shprehur pakënaqësinë për shkak të shembujve ku tatimpaguesi nga shtetet fqinje siç janë Serbia dhe Mali i Zi i diskriminojnë pozitivisht gjatë procesit të regjistrimit në institucione të arsimit të lartë në Kosovë, kurse pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë injorohen për shkak se regjistrimi për ta shpallet vetëm një herë. Madje e nënvizoi faktin se pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë e japin provimin pranues për fakultete vetëm në gjuhën shqipe, që për rezultat pati që në vitin 2015 rreth 100 nxënës të shkollave të mesme ta humbin të drejtën e studimit në Universitetin e Prishtinës. Saliji ka theksuar se komuniteti është i zhgënjyer me faktin se nga 400 vende të rezervuara për studentët që janë pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë, vetëm 30 janë regjistruar në vitin 2015. Në fund të diskutimit të

tij, z. Saliji ua bëri thirrje pushtetit lokal dhe qendror për një bashkëpunim më të mirë me Këshillin Konsultativ për Komunitete, dhe me përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë.

Në drejtimin e tij, **Ministri i Arsimit, Shkencës dhe teknologjisë, z. Arsim Bajrami** tha që arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësia janë prioritetet kyçe të MASHT-it, përveç kësaj arsimit i komuniteteve jo shumicë në Kosovë nuk është vetëm e drejta, por edhe baza për një zhvillim individual, për kuptimin e diversitetit, promovimi dhe respektimi i të drejtave të njeriut në përgjithësi.

Ministri Bajrami tha se Ministria e Arsimit i ka siguruar tekstet mësimore falas për të gjithë nxënësit, duke i përfshirë edhe nxënësit nga komunitetet jo shumicë, me përjashtimin e komunitetit Serb i cili ende nuk është përfshirë në sistemin e arsimit kosovar. Ministri Bajrami gjithashtu ka folur edhe për arsim të lartë dhe me këtë rast tha që për studentët nga komunitetet jo shumicë janë siguruar kuotat për regjistrim dhe e ka cekur faktin se në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren, mësimi zhvillohet në 3 gjuhë, kurse në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë, ligjërata zhvillohen edhe në gjuhën boshnjake.

Z. Bajrami i ka njoftuar të pranishmit është formuar komisioni për verifikimin e diplomave nga Universiteti në Mitrovicë të Veriut, dhe që në të ardhmen, pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë të cilët kanë diplomuar në Universitetin e përmendur do t’iu mundësohet që të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në konkurset për punësim. Përveç kësaj, Ministri Bajrami tha që MASHT-i do ta sigurojë infrastrukturën ligjore për avancim dhe përkrahje të Qendrave të Arsimit, si dhe shpërblimet për regjistrimin e studentëve në Universitetin e Prishtinës. Z. Bajrami gjithashtu theksoi se MASHT-i do t’i shpallë tekstet mësimore për komunitetin boshnjak dhe turk, si dhe tekstet mësimore në gjuhën romë. Ministria gjithashtu do t’i përkushtohet edhe zbatimit të “Strategjisë dhe planit aksion për integrimin e komunitetit Rom, Ashakli dhe Egjiptian në shoqëri kosovare, 2016/20”, dhe do ta organizoj një trajnim për aplikimin e këtij planit dhe programit mësimor të Kosovës për mësimdhënien në gjuhët boshnjake dhe turke.

Në fund të diskutimit të tij, Ministri Bajrami tha që në bashkëpunim me KFOS do ta aplikojë projektin IPA 2014, në mënyrë që komunitetet jo shumicë të integrohen plotësisht në sistemin e arsimit të Kosovës.

**Ambasadori i Mbretërisë së Norvegjisë, z. Jan Braathu** tha se arsimit është e drejta kushtetuese dhe kjo e drejtë duhet të respektohet në Kosovë.

Z. Braathu e ka shprehur mirëseardhjen për faktin që institucionet ndërkombëtare dhe partnerët i ndihmojnë programet dhe projektet në fushë të arsimit, por ka theksuar që edhe institucionet vendore në bashkëpunim me komunitetet në Kosovë duhet ta sigurojnë të drejtën e barabartë në arsim për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Ambasadori Braathu tha që është për keqardhje, që sot, ende nëpër disa shkolla në territorin e komunës së Prizrenit, për mësimdhënie në gjuhën boshnjake përdoren tekstet mësimore

nga viti 1989, dhe e ka përshëndetur gatishmërinë e Ministrisë dhe të Qeverisë për gjetjen e zgjidhjes për verifikimin e diplomave nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, duke pasur parasysh se një numër i madh i studentëve nga komunitetet jo shumicë, që nuk studiojnë në gjuhën shqipe, atje e përfundojnë arsimin e lartë të tyre.

Ambasadori e ka përshëndetur pikën të cilën e përmendi Kryesuesi i Grupit punues për Arsim. Z. Saliji, në të cilën theksohet nevoja e komuniteteve jo shumicë që ta mësojnë gjuhën e popullatës shumicë shqiptare, për shkak të integritit sa më të mirë, dhe ka theksuar së është më shumë rëndësi që pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në ligjëratat të tyre ta mësojnë edhe gjuhën shqipe, gjë që më vonë do t'ju lehtësojë qasjen në jetën institucionale dhe publike në Kosovë.

Ne fund të diskutimit të tij, z. Braathu e ka nënvizuar se arsimi cilësor ka rëndësi më të madhe për të gjithë në Kosovë, dhe që kjo nuk është çështje e përkatësisë etnike dhe e ka shprehur mbështetjen e plotë për Ministrin Bajrami në drejtim të sigurimit të arsimit cilësor në Kosovë.

**Drejtori i USAID/it në Kosovë, James Hope**, e ka shprehur kënaqësinë që është i pranishëm në takim ku po diskutohet për arsim të komuniteteve jo shumicë në Kosovë, ka theksuar se “arsimi cilësor ka një rëndësi të madhe për Kosovë, dhe që investimi në arsim është pjesë kyçe për ndërtimin e një shoqërie dhe të një shteti cilësor”. Z. Hope ka theksuar se qëllimi i mbështetjes financiare, të Shteteve të Bashkuara Amerikane, për projektet për arsim në 82 vende të botës, është mundësia e barabartë për arsim për të gjithë pjesëtarët, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike dhe njëkohësisht e ka përshëndetur gatishmërinë e MASHT-it që ta sigurojë arsimin e barabartë për të gjithë qytetarët e Kosovës, sipas parimeve të njëjta. Ne diskutimin e tij të mëtejshëm, z. Hope i ka përmendur edhe projektet që USAID-i i zbaton në Kosovë, në bashkëpunim me Qeverinë dhe Ministrinë e Arsimit, ndër të tjera e theksoi programin e “Leadershipit transformativ” (“TLP program”) i cili ua jep mundësinë edhe studentëve nga komunitetet jo shumicë që shkollimin e tyre, me një bursë ta vazhdojnë në Shtetet e Bashkuara Amerikane, të cilët, pas përfundimit të studimeve do të kthehen në Kosovë dhe do ta japin kontributin e tyre në ndërtimin dhe forcimin e shtetit. Z. Hope veçanërisht e ka theksuar rëndësinë e projektit për hapjen e 5 qendrave në Kosovë për ndihmë në arsim për pjesëtarët më të rinj të komuniteteve, ku të punësuarit nëpër këto qendra do t'ju ndihmojnë nxënësve që sa më lehtë ti përballojnë mësimet dhe t'i bëjnë detyrat e shtëpisë, por gjithashtu ato do të shërbejnë edhe për konsultim me prindër në lidhje me arsimin e fëmijëve të tyre.

**Përfaqësuesja e Ambasadës Zvicërrane në Kosovë, znj. Saskia Salzman** ka theksuar rëndësinë e mësimet të gjuhës shqipe nëpër shkolla, për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë, por dhe rëndësinë e mësimet të gjuhës serbe nëpër shkolla shqiptare, ngaqë gjuha serbe është gjithashtu një nga gjuhët zyrtare në Kosovë. Ambasada Zvicërrane, s ai përket arsimit, më shumë fokusohet në përdorimin e gjuhës, ngaqë bashkëpunon ngushtë me Zyrën e Komisionerit për gjuhët, të cilët e kanë përgatitur strategjinë për zbatimin e Ligjit për

përdorimin e gjuhëve në Kosovë, me të cilën është parashikuar edhe mësimi i gjuhës shqipe dhe asaj serbe nëpër shkolla në Kosovë. Znj. Salzman gjithashtu e ka vlerësuar si shumë të rëndësishëm procesin e verifikimit të diplomave nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut.

**Deputeti në Kuvendin e Kosovës, z. Kujtim Paqaku** ka theksuar se çështja e arsimit është një çështje tepër e rëndësishme për komunitetin rom në Kosovë. Z. Paqaku ka theksuar se e ka kënaqësinë që nga Ministri ka dëgjuar çka është bëtë deri tani dhe çka është ne plan të bëhet, por nuk i vjen mirë që për shkak të fajit të Ministrisë një grup i nxënësve të shkollës së mesme nga komuniteti rom në Prizren, e kanë humbur regjistrimin në Universitetin e Prizrenit. Paqaku ka theksuar që regjistrimi i studentëve të nacionalitetit rom është pamundësuar edhe pse ka ekzistuar dëshira e Ministrit që studentët të regjistrohen në Universitetin e Prishtinës, nuk ka ekzistuar vullneti politik nga udhëheqja e Rektoratit të Universitetit të Prishtinës, edhe pse deputetët, janë përpjekur që nga ministria, rektorati dhe deri te ambasada ta zgjidhin këtë problem. Z. Paqaku ka kërkuar nga Ministria e Arsimit që t'i organizojë trajnimet për mësimdhënësit nga komuniteti rom, të cilët japin mësim në mësimdhënien zgjedhore. Në fund të diskutimit të tij, z. Paqaku ka kërkuar nga Ministri angazhim më të madh dhe bashkëpunim më të mirë mes Ministrisë, Rektoratit dhe përfaqësuesve të komuniteteve, për t'iu shmangur problemeve nga viti 2015.

Në emër të komunitetit boshnjak, në takim u drejtua **deputetja në Parlamentin e Kosovës, znj. Emilija Redžepi**. Z. Redžepi iu falënderua Qeverisë së Kosovës dhe Ministrisë për bashkëpunim deri më tashëm dhe për gatishmërinë e tyre që pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë t'iu dalin përballë në fushën e arsimit. Znj. Redžepi e ka shfaqur mendimin që është gjë e mirë që problemi i teksteve mësimore po zgjidhet me importimin e librave nga Bosnja dhe Hercegovina, por ka theksuar se konsideron që kishte qenë më mirë që në përpilimin e teksteve mësimore për mësimdhënien në gjuhën boshnjake të kyçën edhe autorët nga Kosova, duke e pasur parasysh faktin që tekstet mësimore nga Bosnja dhe Hercegovina nuk i përshtatën planit dhe programit të MASHT-it në Kosovë. Znj. Redžepi iu falënderoi Ministrisë për Arsim për marrëveshjen e arritur, mbi hapjen e drejtimit ekonomik në gjuhën boshnjake në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, the ka cekur që në lidhje me këtë gjë është marrë vendimi i Senatit të Universitetit, por është e domosdoshme edhe mbështetja e ministrit për arsim për realizimin e kësaj nisme, duke pasur parasysh, siç tha ajo, që në ribalansin e buxhetit duhet të ndahen mjete për financimin e stafit mësimdhënës për drejtimin e përmendur. Në përgjigjen e tij, ndaj pyetjeve të pjesëmarrësve, Ministri Bajrami iu referoj edhe diskutimit të znj. Redžepi, dhe theksoi që drejtimi i përmendur do të jetë i hapur dhe që financimi i këtij drejtimi do të sigurohet nga ribalansi i ardhshëm i buxhetit.

Në fund të diskutimit të saj, znj. Redžepi ka kërkuar nga ministri që ta zgjidh problemin e kuotave të numrit të nxënësve nëpër shkolla fillore, të cilat janë të definuara me Regulloren Administrative, e të cilat në zonat rurale, në territorin e komunës së Prizrenit paraqesin

problem për komunitetin boshnjak, duke e pasur parasysh faktin që për shkak të largësisë së shkollave, pjesëtarët e komunitetit boshnjak gjithnjë e më shumë emigrojnë në qytete.

Zëvendësi i Avokatit të Popullit në Kosovë, z. Ibrahim Arslan ka theksuar se problemet në arsimin e komuniteteve jo shumicë shumë shpesh mbesin në nivelin e vet komunitetit sepse mungon komunikimi i komuniteteve me institucione që e kanë për detyrë t'i zgjidhin problemet. Z. Arslan ka theksuar se medijat duhet ta ndërmarrin rolin kryesor në njoftimin e publikut dhe të institucioneve në Kosovë për këtë problem nëpërmjet diskutimeve të hapura gjatë të cilave do të diskutohej publikisht për këto probleme.

Përfaqësuesi i komunitetit goran në Këshillin Konsultativ për Komunitete, z. Fergap Zaimi të pranishmëve ua shpjegoi gjendjen aktuale në Gorë, dhe theksoi se nga 6 shkolla fillore dhe një shkollë të mesme, në të cilat mësimet i ndjek rreth 1000 nxënës nga komuniteti goran, asnjë nuk është me seli në komunën e Dragashit. Z. Zaimi ka theksuar se nga viti 1999 në komunën e Dragashit ka funksionuar shkolla fillore dhe ajo e mesme, dhe që të njëjtat pas luftës në Kosovë janë zhvendosur neperë fshatra ku mësimi zhvillohet me probleme të mëdha. Z. Zaimi në vazhdim, gjithashtu e ka paraqitur faktin se fëmijët dhe stafi mësimdhënës nga komuniteti goran, në disa fshatra nuk ka qasje ndaj ndërtesave të shkollave, që rezulton me faktin se në disa prej shkollave, mësimi zhvillohet në tri ndërrime.

Z. Zaimi në vazhdim theksoi se ndërtesat e shkollave në mjedisin goran kurrë nuk kanë qenë të rinovuara dhe që nuk ekzistojnë as kushtet baze për punë duke filluar nga klasat adekuate, kabinetet, sallat sportive dhe ndriçimit.

Z. Zaimi gjithashtu ka theksuar se një ndër problemet më të mëdha është transportin e nxënësve të dhe ka kërkuar nga Ministri Bajrami angazhim personal në zgjidhjen e probleme në fushën e arsimit më të cilat po ballafaqohet komuniteti goran. Në referimin e tij në pyetjet dhe prezantimin e z. Zaimi. Ministri Bajrami e theksoi gatishmërinë që ta vizitojë Gorën dhe shkollat në komunitetin goran, ka kërkuar nga z. Zaimi që t'u bashkëngjitet përpjekjeve të përbashkëta për t'i zgjidhur këto probleme me të cilat po ballafaqohet komuniteti goran në Kosovë.

Përfaqësuesi i komunitetit turk në Këshill, dhe anëtari i Grupit punues për çështje të Arsimit, z. Agim Rifat që komuniteti turk po ballafaqohet me mungesën e një numri të teksteve mësimore, domosdoshmërinë e shtypjes rreth 40% të teksteve mësimore të nevojshme, mungesën e lekturës shkolllore, mungesën e përfaqësuesve të komunitetit turk në autoritetet dhe bordet administrative për arsim, mungesën e aftësisë bashkëkohor dhe ngritjes së cilësisë në arsim dhe në mësimdhënien në gjuhën turke. Në fund të diskutimit të tij, z. Rifat e ka lavdëruar kontributin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, BE dhe të Turqisë për mbështetjen që ia kanë ofruar Kosovës në fushën e arsimit.

Në përfundim, Ministri Bajrami iu falënderoi Këshillit Konsultativ për Komunitete, për organizimin e këtij forumi dhe e ka shprehur gatishmërinë e institucionit që në të ardhmen të bashkëpunojë me Këshill, por edhe me përfaqësuesit e tjerë me qëllim të sigurimit të

arsimit të barabartë dhe cilësor për të gjithë qytetarët e Kosovës pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike. Ministri Bajrami ka theksuar se Ministria, në periudhën e ardhshme, do të përpiqet që në administratën e vet ta forcojë Divizionin për arsimin e komuniteteve jo shumicë, që siç tha ai, edhe më shumë do ta përmirësojë cilësinë e arsimit të pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë.

Anëtari i Këshillit dhe Kryesuesi i Grupit punues për Çështje gjuhësore, z. Taner Güçlütürk gjithashtu e ka theksuar që ende ekziston mungesa e teksteve mësimore në gjuhën turke, si dhe faktin që teksti mësimor në gjuhën shqipe për mësimdhënien në gjuhën turke, ende ekziston vetëm për klasën e tretë që drejt për drejtë e vështirëson integrimin gjuhësor të pjesëtarëve të komunitetit turk në Kosovë. Z. Güçlütürk e ka theksuar edhe mungesën e trajnimeve për mësimdhënësit për mësimdhënien në gjuhën turke që i organizon MASHT-i.

Në fund të takimit, Kryesuesi i Këshillit Konsultativ për Komunitete, z. Darko Dimitrijević i paraqiti përfundimet nga takimi ku ka theksuar se ekziston përkushtimi i Qeverisë dhe i Ministrisë së Arsimit që të përmirësohet cilësia e arsimit për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe ka theksuar se arsimit cilësor ka rëndësi të veçantë për mbijetesën e tyre dhe për ruajtjen e gjuhës dhe të kulturës në Kosovë; Z. Dimitrijević e ka shprehur shpresën që komisioni për njohjen e diplomave nga Universiteti në Mitrovicën e Veriut do ta vazhdojë punën e vet, por që gjithashtu ende nuk ekziston integrimi i plotë i të gjitha komuniteteve në sistemin arsimor të Kosovës. Z. Dimitrijević ka theksuar se ekziston problemi me tekstet mësimore në gjuhët amtare si dhe mungesa e lekturës shkollore, ai e theksoi edhe rëndësinë e futjes së lëndëve të gjuhëve zyrtare në Kosovë, në mësimdhënien e rregullt, por edhe atë shtesë.